

Specifikime Teknike – Prokurim i produkteve Pajisje dhe Solutions

1. Objekti i kontratës

Ky dokument përcakton specifikimet teknike dhe kërkesat për prokurimin e produkteve/zgjidhjeve teknike të nevojshme për mbështetjen e implementimit të kërkesave të ISMS, të përmbledhura në Tenderin Nr. 1. Dokumenti përfshin tre paketa prokurimi (Tenderi Nr. 2, Tenderi Nr. 3 dhe Tenderi Nr. 4), të trajtuara brenda të njëjtit kuadër teknik dhe administrativ.

2. Qëllimi i kontratës:

Qëllimi është sigurimi i produkteve dhe shërbimeve të domosdoshme për rritjen e qëndrueshmërisë operacionale, ruajtjen dhe rikuperimin e të dhënave, si dhe modernizimin e mjedisit të punës, në përputhje me praktikën e mira të sigurisë së informacionit dhe kërkesat rregullatore në fuqi.

3. Arsyetimi dhe konteksti rregullator

Kërkesat e këtij procesi prokurimi lindin si një nevojë e pritshme dhe e natyrshme që buron nga objektivat e përcaktuara në Tenderin Nr. 1, i cili ka për qëllim ngritjen dhe standardizimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (ISMS). Edhe pse vlerësimi përfundimtar i gjetjeve të tenderit të parë nuk është kryer ende, nga analiza paraprake dhe nga natyra e vetë projektit rezulton e qartë se disa produkte dhe pajisje teknike janë të domosdoshme për të mundur zbatimin efektiv të kërkesave të ISMS dhe përputhshmërinë me kuadrin rregullator në fuqi. Për këtë arsye, këto kërkesa prokurohen paralelisht, në mënyrë që infrastruktura mbështetëse të jetë e gatshme për fazat e mëtejshme të implementimit.

4. Përshkrimi i punës (Scope of Work)

- Furnizim, instalim dhe konfigurim i produkteve dhe pajisjeve për ruajtje/rikuperim të të dhënave dhe mjedisin e punës.
- Integrim me mjedisin ekzistues dhe zbatimin e politikave teknike sipas praktikave të ISMS.
- Testim funksional dhe dorëzim i dokumentacionit teknik (manuale, runbook, skema konfigurimi).

5. Deliverables

- Produkte/pajisje të instaluara dhe të testuara sipas specifikimeve.
- Dokumentacion teknik dhe operativ (runbook, konfigurime, skema, licenca, garanci).
- Raport testesh (test-backup/test-restore, test funksional për pajisjet e punës).

6. Paketat e prokurimit

6.1. Paketa A – Zgjidhja e Backup-it (Backup Solution)

Kërkesat teknike minimale për zgjidhjen e backup-it janë:

- Kapacitet minimal 20 TB RAW.
- Konfigurim i rekomanduar RAID 5 ose RAID 6 për tolerancë ndaj dështimeve.

ANEKS B – Tender 2, 3 & 4

- Kompatibilitet i detyrueshëm me Veeam Backup & Replication (repository integration, Data Mover, Fast Clone / ReFS/XFS, Full/Incremental/Synthetic Full, Health Check).
- Encryption at-rest (AES-256) dhe in-transit (TLS 1.2+).
- Testim automatik i integritetit të backup-eve dhe mundësi test-restore pa ndikim në prodhim.
- Restore granular (file-level / VM-level).
- Përputhje me Ligjin 25/2024, Ligjin 124/2024 dhe ISO/IEC 27001:2022.

Forma e pajisjes: ****Rack-mounted**** është e preferuar, por ****nuk është e detyrueshme****; ofertuesi mund të propozojë formate të tjera që përmbushin kërkesat funksionale.

6.2. Paketa B – Prokurimi i 15 PC-ve

Kërkesat teknike minimale për pajisjet e punës janë:

- Brand i njohur (HP, DELL ...)
- Form factor: Desktop (jo Laptop)
- CPU: Benchmark score 10,000 pike
- RAM: 16 GB DDR4/DDR5
- Storage: 512 GB SSD NVMe.
- Rrjeti: 1 Gbps Ethernet;
- OS: Windows 11 Pro (licencë origjinale).

6.3. Paketa C – Prokurimi i 2 Racks (Kabinete server-ash) – (në përputhje me kërkesat fizike të kontrollit A.7 dhe A.8 të ISO 27001)

- Kabinet serverash (Rack) 19", minimum 42U, me dyer të mbyllshme dhe bravë sigurie, thellësi ≥ 800 mm, strukturë metalike, kapacitet ≥ 600 kg, ventilim pasiv, panele anësore të kyçshme, hapësira të menaxhimit të kablllove, mbështetje për PDU vertikale dhe tokëzim.

7. Komponentë shtesë dhe parashikime nga ofertuesi

- Ofertuesi duhet të specifikojë dhe përfshijë të gjitha licencat e domosdoshme për funksionimin e zgjidhjeve të propozuara.
- Ofertuesi duhet të parashikojë komponentë/aksesorë shtesë (p.sh. media units, expansion units, kablllo, module rrjeti) për ta vënë zgjidhjen në punë "end-to-end".
- Ofertuesi duhet të paraqesë parashikime për nevojat e ardhshme (plan zgjerimi, licenca shtesë, shelves/disque, opsione offsite/cloud) dhe koston totale të pronësisë (TCO) për 3–5 vite

8. Preferenca për ofrimin e unifikuar

Është e preferueshme që i njëjti ofertues të ofrojë të dy produktet/zgjidhjet (Paketa A dhe Paketa B), me qëllim të thjeshtimit të integritetit, përgjegjësisë dhe mirëmbajtjes; ****megjithatë, kjo nuk është e detyrueshme**** dhe palët mund të paraqesin oferta të ndara për secilën paketë.

9. Menaxhimi i projektit dhe afatet

- Plan pune i detajuar me faza dhe afate të propozuara nga ofertuesi.
- Aktivitete dorëzimi: instalim, konfigurim, testim, dokumentacion dhe dorëzim zyrtar.
- Trajnim bazë për stafin përdorues/operativ (nëse kërkohet nga autoriteti kontraktor).

ANEKS B – Tender 2, 3 & 4

10. Bazë ligjore dhe standarde reference

- Ligji 25/2024 – masat teknike të sigurisë së informacionit.
- Ligji 124/2024 – masat teknike dhe organizative të duhura.
- ISO/IEC 27001:2022 – kërkesat për ISMS